

04/ZDP/VE/2024
Datë: 23 shkurt 2024

Në mbështetje të neneve 2, 14.2, 35, 36 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, i ndryshuar me Ligjin Nr.08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhëse të Agjencive të Pavarura, nenit 24 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizmin dhe Funksinin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, nenit 53 të Ligjit Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, Marrëveshjes për Shërbime të Rregullta Ajrore ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit Federal të Zvicrës, të datës 30 nëntor 2010 dhe Memorandumit të Mirëkuptimit për marrëveshje për shërbime ajrore të datës 29 prill 2009 në mes të Autoriteteve të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës dhe Këshillit Federal të Zvicrës,

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil (më tutje "AAC") nxjerr:

VENDIM

- SHFUQIZOHET Vendimi me nr. 03/ZDP/VE/2024 të dt. 16 shkurt 2024.
- Me shfuqizimin e Vendimit nga pika 1, anulohet procesi i Thirrjes publike për shprehje interesi për operatorët ajrorë të cilat mund të ofrojnë plane fluturimi dhe kapacitete me orar të programuar fluturimesh për të fituar të drejtën e fluturimit përmes emërimit (dezinimit) në destinacionet nga Republika e Kosovës në Këshillin Federal të Zvicrës dhe anasjelltas.
- Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Më datën 16 shkurt 2024, AAC ka Vendosur përmes Vendimit 03/ZDP/VE/2024 të shpallë Thirrjen publike për shprehje interesi për operatorët ajrorë të cilat mund të ofrojnë plane fluturimi dhe kapacitete me orar të programuar fluturimesh për të fituar të drejtën e fluturimit përmes emërimit (dezinimit) në destinacionet nga Republika e Kosovës në Këshillin Federal të Zvicrës dhe anasjelltas.

Procesi i dezignimit ka për qëllim mbrojtjen e interesit publik dhe atij shtetëror, me synim që të kufizojë monopolin dhe rrjedhimisht të sigurojë shërbime të mira me çmime konkurente dhe të arsyeshme për udhëtarët, nga një operator ajror me qëndrueshmëri operacionale dhe financiare.

Pas nxjerrjes së Vendimit 03/ZDP/VE/2024 të dt. 16 shkurt 2024, AAC ka pranuar një numër komentesh dhe sugjerimesh nga operatorët ajror, rreth kushteve dhe afatet kohore për përmbushjen e kërkesave të parapara në Thirrjen publike për shprehje interesi.

Duke marrë parasysh komentet dhe sugjerimet e pranuar nga operatorët ajror, Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së, ka vendosur të shfuqizoj Vendimin 03/ZDP/VE/2024, dhe të anuloj procesin e filluar të Thirrjes publike për shprehje interesi për operatorët ajror të cilët mund të ofrojnë plane fluturimi dhe kapacitete me orar të programuar fluturimesh për të fituar të drejtën e fluturimit përmes emërimit (dezignimit) në destinacionet nga Republika e Kosovës në Këshillin Federal të Zvicrës dhe anasjelltas.

AAC do të punoj në sqarimin e mëtutjeshëm të këtyre kritereve, në mënyrë që të siguroj që gjatë këtij procesi të shqyrtohen të gjitha komentet e palëve të interesit, dhe në periudhën në vijim do të publikoj përsëri thirrjen publike për shprehje të interesi.

AAC mbetet e përkushtuar që ky proces të zhvillohet në mënyrë transparente, në interes të publikut dhe konform praktikave më të mira ndërkombëtare.

Nga sa u tha më lartë, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, në pajtim me nenet 2, 14.2, 35, 36 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, i ndryshuar me Ligjin Nr.08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura, nenit 24 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizmin dhe Funkcionin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, nenit 53 të Ligjit Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, Marrëveshjes për Shërbime të Rregullta Ajrore ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit Federal të Zvicrës, të datës 30 nëntor 2010 dhe Memorandumit të Mirëkuptimit për marrëveshje për shërbime ajrore të datës 29 prill 2009 në mes të Autoriteteve të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës dhe Këshillit Federal të Zvicrës, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Alban Ramabaja
UD. Drejtor i Përgjithshëm

Vendimi i dërgohet:

- Ministrit të MMPHI;
- Arkivit të AAC-së.